



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna e Gjiçanit
Opština Gnjilane
Municipality of Gjiçan
Gjiçan Belediyesi

Në mbështetje të nenit 38 paragrafi 1.4 të Statutit të Komunës së Gjiçanit 01. nr. 16-126211 dt. 06.11.2014, dhe në zbatim të nenit 6 paragrafi 3 të Rregullore për ndarjen e Subvencioneve 01.Nr.016-144327 të datës 30.12.2014, Kuvendi i Komunës së Gjiçanit në mbledhjen e mbajtur me 31.03.2016, merr:

V E N D I M

Për ndarjen e mjeteve financiare për Subvencionim të aktiviteteve të Këshillit të Veprimit Rinor Lokal (KVRL) në Gjiçan

1. Me këtë vendim ndahen mjetet financiare në shumën prej 5000.00 € (pesë mijë euro) për subvencionim të aktiviteteve të Këshillit të Veprimit Rinor Lokal në Gjiçan për vitin 2016
2. KVRL në Gjiçan është e obliguar që të paraqes projekt propozimin në të cilin duhet të përshkruhen aktivitetet me agjendë të planifikuar dhe të specifikuar në mënyrë financiare
3. KVRL është e obliguar që të bëjë përmbylljen mjeteve të shpenzuar dhe për këtë të ofroj dëshmi në mënyrë që të përfitoj nga ky subvencionim
4. Mjetet financiare ndahen nga Buxheti i Zyrës së Kryetarit -kategoria e shpenzimeve të Subvencioneve.
5. Për zbatimin e këtij vendimi kujdeset ekzekutivi i Komunës, ndërsa për monitorim të zbatimit kujdeset Kryesuesi i KK-Gjiçan.
6. Ky Vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit të MAPL-së dhe publikimit në gjuhët zyrtare në ueb faqen e Komunës,

01.Nr. 016-30401
Gjiçan, më 31.03.2016

Kryesuesja e Kuvendit,

Valentina Bunjaku-Rexhepi